



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (c), nenit 17, pika (f), nenit 40 paragrafi 2, pika (g), të Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr.28/2008”, nenit 8, pika (a), Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 27/2008”, e në mbështetje të nenit 15, lidhur me nenin 40, të Ligjit Nr. 04/L-60, për mbeturina, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 28/2011” e konform nenit 18, të Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr.07/2015 për menaxhimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore dhe dispozitat nenit 28, lidhur me nenin 29, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur më datën 27.02.2019, miratoi këtë

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim caktohet tarifa në vlerë prej **0.50€ për m³**, për deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, në lokacioni që e ka caktuar Komuna e Suharekës me vendimin me numër 01-Nr-16-7254, të datës 30.06.2015, e që dorëzohen nga prodhuesit dhe krijuesit e mbeturinave ndërtimore dhe demolimi i objekteve ndërtimore.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, përkatësisht Drejtoria për shërbime publike, emergjencë dhe mjedis e Komunës së Suharekës.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 016-15106
Me datë 28.02.2019

